

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Nr. i prokurimit	KEK-26-1156-5-1-1
Nr. i brendshëm	KEKC 26 140 511

Sa i përket tenderit për: **Riparim kapital elektromekanik i Ekskavatorit E8B SRs1300**

## ANKESË

### Identifikimi i ankuesit\*

Emri i Kompanisë: **Bahri Asllani B.I - N.T.SH "EKOINVEST"**

Adresa : **Rruga "Agim Ramadani", Nr. 511/9, Prishtinë, 10 000**

Numri Telefonit: **044/303-068**

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Eron Asllani**

Adresa elektronike: **info@ekoinvest.co**

Data e parashtrimit të ankesës: **22.05.2026**

Nënshkrimi dhe vula:



*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- **B05- Njoftimi për kontrate: 04.02.2026;**
- **Afati për dorëzim të tenderit: 25.05.2026;**
- **Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët**
- **Paraqitja e Kërkesës për Rishqyrtim- 19.05.2026**
- **Përgjigje në Kërkesës për Rishqyrtim – 20.05.2025**

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>					Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	--	----	-------------------------------------	--

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 19.05.2026 përmes platformës së E- Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.** . Me datën 20.05.2026 përmes platformës së E- Prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Autoriteti nuk shqyrton Kërkesën për Rishqyrtim pasi e cilëson si të jashtë afatshme.

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

**Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:**

**Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

**Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**

**Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

**Shkeljet e dispozitave të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, janë:**

**Neni 60 - Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore**

**Neni 63 - Vendimi i Autoritetit Kontraktues,**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me këtë ankesë, kontestojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. – KEK, të datës 20.05.2026, përmes të cilit Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur nga ne si OE Ankues më 19.05.2026 është refuzuar si e dorëzuar jashtë afatit ligjor. Ky refuzim është i pabazuar, sepse AK e ka trajtuar gabimisht rastin sikur bëhej fjalë për një shtyrje të thjeshtë të afatit pas refuzimit të kërkesave paraprake për rishqyrtim, ndërsa faktet procedurale tregojnë të kundërtën: kërkesat paraprake për rishqyrtim të datës 13.05.2026 janë pranuar në substancë, kanë sjellë korrigjime në dokumentet e tenderit dhe kanë prodhuar publikimin e formularit B54 më 14.05.2026, me të cilin afati i dorëzimit të ofertave është shtyrë në 25.05.2026.

AK në vendimin e kontestuar i është referuar Nenit 108/A të LPP-së, Nenit 60.1(a) dhe Nenit 63.1.1(b) të Rregullores për Prokurimin Publik, duke pretenduar se Kërkesa jonë për Rishqyrtim është e jashtëafatshme. Mirëpo këto dispozita, të lexuara në raport me faktet reale të procedurës, nuk e mbështesin vendimin e AK-së. Përkundrazi, ato tregojnë se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit ishte e afatshme dhe se AK ishte e detyruar ta shqyrtonte në meritë.

Deri para datës 13.05.2026, çështja e afateve kishte lëvizur vetëm në kuadër të pyetjeve sqaruese dhe vendimeve të vetë AK-së për shtyrje të afatit. Fillimisht afati ishte 12.05.2026, pastaj përmes B54 të datës 05.05.2026 u shty në 15.05.2026. Mirëpo më 13.05.2026, AK publikoi vendime mbi kërkesat për rishqyrtim të operatorëve ekonomikë, ku pranoi pretendimet e Operatoreve.

Këto veprime janë miratim i kërkesave për rishqyrtim dhe korrigjim i dokumenteve të tenderit. Këtë e vërteton edhe vetë formulimi i vendimit të AK-së, ku në fund përcaktohet që të publikohet sqarim/korrigjim i Dosjes së Tenderit dhe, nëse është e nevojshme, të zgjatet afati për dorëzimin e ofertave, në mënyrë që operatorët ekonomikë të mund të përgatisin oferta të përgjegjshme dhe konkurruese .

Pikërisht pas këtyre vendimeve të datës 13.05.2026, AK më 14.05.2026 publikoi formularin B54 “Njoftim për informata shitesë ose përmirësim i gabimit”, ku është shënuar se afati i fundit për pranimit të tenderëve është ndryshuar nga 15.05.2026 në 25.05.2026 . Ky veprim është në përputhje me Nenin 63.1.3 të Rregullores, i cili përcakton se kur një kërkesë për rishqyrtim që lidhet me njoftimin për kontratë ose dokumentet e tenderit miratohet plotësisht ose pjesërisht, AK duhet të publikojë njoftim për korrigjim të gabimeve duke përdorur formularin B54 dhe duhet të zgjasë afatin e dorëzimit të tenderëve .

Prandaj, pretendimi i AK-së se në këtë rast zbatohet përjashtimi i Nenit 60.1(a), sepse afati është shtyrë pas një vendimi për refuzim sipas Nenit 63.1.1, nuk qëndron. Ky përjashtim do të mund të diskutohej vetëm nëse kërkesat paraprake për rishqyrtim do të ishin refuzuar dhe AK do ta kishte shtyrë afatin pa bërë korrigjime të Dosjes së Tenderit. Në rastin konkret ka ndodhur e kundërta: AK ka pranuar gabime dhe paqartësi, ka ndryshuar dokumentet e tenderit, ka publikuar B54 dhe ka shtyrë afatin për dorëzim të ofertave. Rrjedhimisht, data relevante për llogaritjen e afatit të Kërkesës për Rishqyrtim nuk mund të jetë më data e vjetër 12.05.2026, por data e re dhe zyrtare 25.05.2026.

Neni 108/A i LPP-së dhe Neni 60.1(a) i Rregullores e lidhin afatin për kërkesë për rishqyrtim me “afatin e fundit për dorëzim të ofertave”, jo me afatin fillestar, jo me afatin e mëparshëm dhe jo me një datë që është zëvendësuar nga vetë AK. Rregullorja përcakton se kur kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin për kontratë ose dokumentet e tenderit, ajo paraqitet së paku pesë ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave, ndërsa dita e dorëzimit të ofertave është dita zero . Duke marrë për bazë afatin aktual 25.05.2026, data 25.05.2026 është dita zero, data 24.05.2026 dita e parë, 23.05.2026 dita e dytë, 22.05.2026 dita e tretë, 21.05.2026 dita e katërt dhe 20.05.2026 dita e pestë. Kërkesa jonë është paraqitur më 19.05.2026, pra para ditës së pestë, dhe si e tillë është dorëzuar brenda afatit ligjor.

Vendimi i AK-së është kontradiktor edhe në vetvete. AK pranon se afati i fundit për dorëzimin e ofertave është 25.05.2026, por pastaj e kthen llogaritjen te data 12.05.2026 dhe pretendon se afati për kërkesë për rishqyrtim ka qenë 07.05.2026. Ky arsyetim nuk mund të qëndrojë, sepse data 12.05.2026 nuk ishte më afati i fundit i dorëzimit të ofertave. Ajo ishte zëvendësuar fillimisht me datën 15.05.2026 dhe më pas, pas miratimit/korrigjimit të kërkesave paraprake për rishqyrtim, me datën 25.05.2026. AK nuk mund ta përdorë datën 25.05.2026 për pranimin e ofertave, por datën 12.05.2026 për kufizimin e të drejtës për rishqyrtim, pasi që kjo krijon dy standarde brenda të njëjtës procedurë

Baza e ankesës pranë OSHP-së është gjithashtu e qartë. Ankuesi ka ndjekur procedurën paraprake duke paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së. AK ka nxjerrë vendim refuzues më 20.05.2026. Kundër çdo vendimi të AK-së, ankuesi ose pala e interesuar mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së, ndërsa Neni 64 i Rregullores përcakton se ankesa pranë OSHP-së dorëzohet pas procedurës paraprake dhe brenda dhjetë ditëve pas vendimit të AK-së .

Për shmangie të çdo dyshimi, ne si OE ankues theksojmë se pretendimet materiale të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 19.05.2026 mbeten në tërësi në fuqi dhe kërkohet që të shqyrtohen nga OSHP. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me paqartësi dhe mospërputhje në Dosjen e Tenderit, konkretisht me pozicione të papërcaktuara paushall, kërkesa teknike kontradiktore dhe kritere të paharmonizuara për dimensionimin e pajisjeve elektrike. Këto çështje ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen e ofertës dhe në krahasueshmërinë e saj, prandaj Kërkesa për Rishqyrtim duhet të shqyrtohet në meritë nga Autoriteti Kontraktues. Këto çështje pamundësojnë ofertim të saktë, krahasues dhe të përgjegjshëm, si dhe cenojnë konkurrencën e barabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

## **Pretentimi 1**

Sipas vlerësimit teknik të partnerit tonë gjerman FAM GmbH konsiderojmë se duhet të rishqyrtohet kërkesa e Autoritetit Kontraktues e përfshirë në listën e çmimeve:

- *Pjesës mekanike, respektivisht Pozicionin 41, ku është përcaktuar “Punët shtesë në funksionalizimin e ekskavatorit (paushall)” si dhe*
- *Pjesa elektrike, respektivisht Pozicionin 99, ku është përcaktuar i njëjti formulim “Punët shtesë në funksionalizimin e ekskavatorit (paushall)”*

Në pjesën mekanike Pozicioni 41 është dhënë si set 1, ndërsa në pjesën elektrike Pozicioni 99 është dhënë po ashtu si set 1. Këto pozicione, të kombinuara me klauzolën e përgjithshme se:

- *“punët shtesë të cilat dalin gjatë riparimit kapital (me çelës në dorë)” janë përgjegjësi e kontraktuesit për ta bërë ekskavatorin funksional,*

krijojnë obligim të paqartë, të pakufizuar dhe të pakalkulueshëm për ofertuesin.

Kjo kërkesë është e papranueshme në formën aktuale, sepse nuk përcakton se cilat punë shtesë përfshihen, cilave pozicione u referohen, cili është kufiri teknik dhe financiar i ndërhyrjes, cilat janë sasi të, cilat janë kriteret e pranimit dhe në cilat raste aktivizohet ky pozicion gjatë implementimit. Në mungesë të këtyre të dhënave, OE detyrohet të japë çmim paushall për një objekt të panjohur pune, gjë që bie ndesh me kërkesën që specifikimet teknike dhe funksionale të jenë të sakta, të matshme dhe të krahasueshme, në kuptim të nenit 28, pika 8 të LPP-së.

Paqartësia është edhe më serioze për shkak të natyrës së projektit. Ky nuk është riparim i zakonshëm, por remont kapital elektromekanik i ekskavatorit SRs 1300 E-8B. Në këto rrethana, “punët shtesë” nuk mund të trajtohen si punë të vogla anësore.

Sipas vlerësimit teknik të partnerit tonë gjerman FAM GmbH, kompani me kredibilitet të lartë ndërkombëtar në fushën e makinerive minerare dhe sistemeve të rënda industriale, shkalla e ndërhyrjes në këtë projekt është përafërsisht rreth 85% në pjesën elektrike dhe rreth 60% në pjesën mekanike. Kjo tregon se “punët shtesë” nuk janë element i vogël apo aksesor, por mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në çmim, afat, përgjegjësi dhe funksionalizim.

Kjo paqartësi krijon edhe konflikt me kushtet kontraktore. Drafti i kontrates ne Dosje te Tenderit parasheh se nëse kontraktuesi has në pengesa që nuk janë rezultat i joprofesionalizmit të tij, ose nëse AK, shërbimet publike apo palë të tjera shkaktojnë vonesa apo kosto shtesë, çmimi i kontratës mund të rregullohet. Mirëpo, përmes Pozicionit 41, Pozicionit 99 dhe klauzolës “me çelës në dorë”, AK mund të tentojë që çdo punë të paparashikuar ta përfshijë brenda paushallit, duke neutralizuar mekanizmin kontraktor për kompensim dhe rregullim të çmimit. Kjo krijon pasiguri juridike dhe rrezik serioz për konteste gjatë implementimit.

Rreziku bëhet edhe më i madh për shkak se kontrata parasheh afat maksimal prej 400 ditësh nga data e nënshkrimit dhe dëm të likuiduar prej 0.50% për çdo ditë vonese, deri në 10% të vlerës totale të kontratës. Nëse “punët shtesë paushall” mbeten të papërcaktuara, kontraktuesi mund të detyrohet të kryejë punë të paparashikuara, pa çmim të qartë, pa afat shtesë dhe nën presionin e dëmeve të likuiduara. Kjo nuk është e balancuar dhe nuk i mundëson OE-së të përgatisë ofertë të përgjegjshme, reale dhe teknikisht të mbrojtshme.

Për këto arsye, kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta largojë Pozicionin 41 dhe Pozicionin 99 në listen e çmimeve ose t'i riformulojë në mënyrë të qartë dhe të matshme. Nëse AK konsideron se këto pozicione janë të domosdoshme, duhet të përcaktojë saktë se cilat punë përfshihen, cilave pozicione u referohen, cilat janë sasi të, kufijtë teknikë dhe financiarë, kriteret e pranimit dhe cilat punë përjashtohen. Duhet të saktësohet shprehimisht se këto pozicione nuk përfshijnë defekte të fshehura, mospërputhje ndërmjet gjendjes reale dhe dokumentacionit të tenderit, ndryshime të projektit, kërkesa të reja të AK-së, mungesa në projekt ekzekutiv, ridizajnime të paparashikuara ose furnizime/intervenime jashtë listës së çmimeve.

Në përfundim, Pozicioni 41 dhe Pozicioni 99, në formën aktuale, nuk mundësojnë kalkulim të drejtë të çmimit, cenojnë krahasueshmërinë e ofertave dhe krijojnë rrezik të lartë për konteste gjatë zbatimit. Për këtë arsye kërkohet që AK ta largojë ose ta saktësojë këtë kërkesë në përputhje me nenin 28 të LPP-së, transparencën, barazinë e trajtimit dhe konkurrencën efektive.

## **Pretentimi 2**

Në dokumentin **Specifikimin teknik – Elektri**, pika **5.6.2** kërkesa për **Elektromotorët me shndërrues të frekuencave** është teknikisht e paqartë dhe kontradiktore, sepse për të njëjtin parametër “përdredhja/momenti tripping” janë dhënë dy kushte që nuk mund të plotësohen njëkohësisht:

- Përdredhja tripping  $\leq 1.6 \times M_{nom}$  dhe
- Përdredhja tripping  $\geq 1.8 \times M_{nom}$ .

Kjo do të thotë se momenti impuls për të cilin duhet dimensionuar motori kërkohet të jetë njëkohësisht më i vogël ose i barabartë me  $1.6 \times M_{nom}$  dhe më i madh ose i barabartë me  $1.8 \times M_{nom}$ , gjë që është matematikisht dhe teknikisht e pamundur.

Për këtë arsye, është i nevojshëm korrigjimi i këtij gabimi në pikën 5.6.2. Në formën aktuale, kërkesa nuk mund të merret si kriter i vlefshëm për pajtueshmëri teknike, sepse plotësimi i njërës vlerë e përjashton automatikisht plotësimin e tjetrës.

## **Pretendimi 3**

Në dokumentin **Specifikimin Teknik – Elektri**, pika **5.5.2 Kerkesat e Pergjithshme** përcakton se fuqia e shndërruesit të frekuencave duhet të jetë së paku **30% më e madhe se fuqia e elektromotorëve**, ndërsa pika **5.5.3 Struktura e Sistemeve të Konvertimit** kërkon që struktura e sistemeve të konvertimit të përballojë **ngarkesë të vazhdueshme  $1.5 \times M_n$** .

Këto dy kërkesa nuk janë të harmonizuara ndërmjet vete dhe janë në kundërshtim me njëra tjetren. Kjo paqartësi krijon konfuzion për operatorët ekonomikë, pasi që nuk dihet nëse dimensionimi i sistemeve të ngasjes dhe ofertimi i tyre duhet të bëhet sipas kriterit  **$1.3 \times P_n$**  apo sipas kriterit  **$1.5 \times M_n$** .

Duke qenë se Dosja e Tenderit parasheh se punët duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike dhe se mospërputhja me to mund të çojë në diskualifikim, kjo mospërputhje krijon rrezik për trajtim jo të barabartë të ofertuesve dhe për vlerësim subjektiv.

Prandaj, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të harmonizojë pikat 5.5.2 dhe 5.5.3 dhe të përcaktojë qartë kriterin e vetëm të dimensionimit të shndërruesve të frekuencave. Në formën aktuale, kërkesa është e paqartë dhe kontradiktore, si e tillë në kundërshtim me Nenin 28, pika 8 të LPP-së, i cili kërkon që specifikimet teknike të jenë të sakta dhe të mundësojnë përcaktim të qartë të lëndës së kontratës.

Pretendimet materiale të mësipërme nuk janë pretendime të reja, por janë pjesë e së njëjtës kërkesë për rishqyrtim të datës 19.05.2026, të cilën AK gabimisht nuk e ka shqyrtuar. Për këtë arsye, kërkojmë që OSHP t'i marrë në shqyrtim edhe këto pretendime, ose ta urdhërojë AK-në që t'i shqyrtojë ato në themel, në pajtim me LPP-në, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe konkurrencës efektive.

Duke pasur parasysh sa më sipër, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, të konstatojë se kërkesa jonë për rishqyrtim e datës 19.05.2026 është dorëzuar brenda afatit ligjor, të anulojë njoftimin/vendimin e AK-së të datës 20.05.2026 dhe të urdhërojë AK-në që ta shqyrtojë kërkesën tonë për rishqyrtim në themel, me arsyetim të plotë faktik dhe juridik. Në alternativë, kërkojmë që OSHP vetë t'i shqyrtojë pretendimet materiale të ngritura në kërkesën tonë për rishqyrtim. Gjithashtu kërkojmë pezullimin e vazhdimin të aktivitetit të prokurimit deri në vendosjen përfundimtare mbi këtë ankesë.

Bazuar ne faktet e prezantuara me larte, Kërkojmë nga AK qe ankesa jone te aprovohet si tërësisht e bazuar dhe te merret:

## V E N D I M

APROVOHET Kërkesa e Operatorit Ekonomike N.T.SH EKOINVEST (Bahri Asllani B.I.) – Prishtine për Rishqyrtimin e VENDIMIT te Autoritetit Kontraktues me nr. prokurimit KEK-26-1156-5-1-1 (KEKC 26 140 511) titulli i kontratës i dhënë nga Autoriteti Kontraktues: “Riparim kapital elektromekanik i Ekskavatorit E8B SRs1300”. ANULOHET (PRISHET) VENDIMI i atakuar me këtë kërkesë (i përshkruar si me larte).

### 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

Nuk janë definuar deri me tani.
---------------------------------

### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. Dëshmia 1\_Përgjigjet në pyetjet e dorëzuara, të publikuara më 27.04.2026;
2. Dëshmia 2\_Formulari B54 i datës 05.05.2026, me të cilin afati është shtyrë nga 12.05.2026 në 15.05.2026;
3. Dëshmia 3\_Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim i datës 13.05.2026
4. Dëshmia 4\_Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim i datës 13.05.2026
5. Dëshmia 5\_Formulari B54 i datës 14.05.2026, me të cilin afati është shtyrë nga 15.05.2026 në 25.05.2026;
6. Dëshmia 6\_Kërkesa për Rishqyrtim e datës 19.05.2026;
7. Dëshmia 7\_Vendimi i AK-së i datës 20.05.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim

# Dëshmi Transaksioni

## Proof of Transaction



**Raiffeisen**  
**BANK**

Member of RBI Group

### Të dhënat e urdhëruesit / Orderer details

Emri i urdhëruesit / Ordering Customer	BAHRI ASLLANI B.I.
Numri i llogarisë së urdhëruesit / Ordering account number	1501001010933350
Referenca e urdhëruesit / Ordering reference number	FT26142CZCWL
Adresa / Address	AKTASH AGIM RAMADANI BUILDING NO 51

### Të dhënat e përfituesit / Beneficiary details

Emri i përfituesit / Beneficiary name	Organi Shqyrtues i Prokurorimit / Procurement Review Body
Numri i llogarisë së përfituesit / Beneficiary account number	1501001010282577

### Të dhënat e transaksionit / Transaction details

Shuma / Amount	10,000.00
Monedha / Currency	EUR
Kursi i këmbimit / Exchange rate	1.0000
Përshkrimi i pagesës / Payment description	Tarifa e Ankimimit per Aktivitetin: KEK-26-1156-5-1-1 - Riparim kapital elektromekanik i Ekskavatorit E8B
Komisioni / Commission	0
Data / Date	22/05/2026
Kanali i pagesës / Payment channel	imBanking
Statusi i pagesës / Payment status	Ekzekutuar / Executed



Rifreskoni kontaktet tuaja! Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm përmes numrit të telefonit dhe adresës suaj të saktë, ne mund t'ju mbajmë të informuar për çdo ofertë, ndryshim apo produkt/shërbim bankar.

Update your personal and contact details (phone number, address) if they changed since your last update, by visiting the nearest branch of Raiffeisen Bank. Updated contact details allow us to keep in touch with you in real time on new offers, important notice and our products&services.

Kontakti +383 38 222 222 • info@raiffeisen-kosovo.com • www.raiffeisen-kosovo.com

Adresa: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., str. Robert Doll #99 10000 Prishtinë, Kosovë • Swift: RBKOKPR • IBAN: XK05



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI  
PROCUREMENT REVIEW BODY



UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS  
PLAÇANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE  
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



PPQDD11111111111H

Të dhënat e OE  
Podaci EO  
EO data

Bahri Asllani B.I - N.T.SH Ekoinvest, RR. Agim Ramadani, Aktash C1/9, 10000 Prishtine

Përshkrimi  
Opis  
Description

Riparim kapital elektromekanik i Ekskavatorit E8B SRs1300

Numri i prokurimit  
Broj nabavke  
Procurement number

KEK-26-1156-5-1-1

Shuma / Iznos  
Ammount

€ 10000 Euro 00 Ct Data / Datum / Date 220526

Me fjalë / Reçima  
In words

Xhirollogaria  
Broj žiroračuna  
Bank account

1000430070005756

Lëshuar nga  
Izdato od /  
Issued by

OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës  
Potpis i pečat banke  
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave ne OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.